

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar Kryetare,

Do ta nis fjalimin tim pak ndryshe. Do të doja që këtu të ishte zoti Dule për të ballafaquar disa të pavërteta që tha këtu, duke filluar nga fakti që tha se janë bërë zero investime. Sigurisht, dëshira e parë është që ta ftoj në zonën e Finiqit, por, meqenëse nuk jemi ballafaquar atje, dua t'i jap disa shifra dhe fakte që mund t'i gjejë shumë kollaj në buxhetin e shtetit dhe në atë të bashkisë.

Nga viti 2015 e këtej janë bërë këto investime: rruga Kulluricë – Pllakë 1 milion euro; rruga Dermish – Memoraq 90 milionë lekë të rinj; rruga “Fitore Aliko” 70 milionë lekë të rinj; rruga Dermish – Jerm 95 milionë lekë të rinj; rruga Dermish – Navaricë 55 milionë lekë të rinj; rruga Kranë – Qafë Botë një investim 10 milionë euro, ku po punon në mënyrë të drejtpërdrejtë ARRSH-ja, ku përfshihen rrugët Kranë – Ura e Gajtanit dhe Shijan – Ura e Gajtanit, si dhe 10 milionë euro në 3 ujësjellës rajonalë, konkretisht në Merko, Leshnicë, Finiq. Ku janë zero investime?! Përse duhet të dezinformojmë? Përse marrim përsipër t'u referohemi lordëve, të cilët sjellin këtu perifrashime të panevojshme, kur realiteti është ndryshe?

Për t'u kthyer tek të vërtetat, të cilat qytetarët i prekin, jo vetëm në Finiq, por në të gjithë Shqipërinë, do t'i referohem pak historisë së buxhetit, të paktën për 3 vjetët e shkuar.

Kur tërmeti shkundi Shqipërinë, përtej solidaritetit kombëtar dhe ndërkombëtar, shumëkush mendoi se do të duheshin shumë vjet, duke parë edhe fqinjin tonë Italinë, për t'u kthyer në banesa, të cilat sot janë banesa më të mira se sa ato që kishin. Pak muaj më pas, kur pandemia goditi pa mëshirë të gjithë, shumë menduan se skenarët më pesimistë të ekonomisë do të materializoheshin dhe vendet e punës do të përgjysmoheshin. Vitin e shkuar, në shtator, kur Kryeministri Edi Rama foli për energjinë dhe në vijim për një vit dha një mbështetje buxhetore me 270 milionë euro, gjithkush tha se është e tepruar, ka probleme. Ndërkohë që sot këto masa rritën ekonominë, rritën punësimin dhe ende sot e mbajnë inflacionin në një shifër, po ta krahasojmë me të gjitha vendet e tjera në rajon dhe në botë.

Sot duhet pranuar se për këto 3 kriza kaq të vështira për të gjithë, për buxhetin e shtetit, për familjet shqiptare dhe për të gjithë botën, reagimi i menjëhershëm i qeverisë është postulati i vetëm. Reagim

për krizën e fundit me mbështetjen dhe mburojën e energjisë mund të jetë edhe më i apload-uar se sa shumë ekonomi të tjera botërore, të cilat sot e kanë inflacionin dyshifror.

Sot lufta Rusi – Ukrainë është shumë më e gjatë sesa e kemi menduar nga shkurti i këtij viti. Lufta që ndodh, është në forma të ndryshme, është me mjete të ndryshme, por ka qëllim të njëjtë, është luftë për ekonominë, është luftë për të gjuhëzuar kombe, duke kërcënuar me rritjen e varfërisë dhe krizën e urisë. Ky front lufte solli këto rritje çmimesh edhe në Shqipëri, të cilën e ndjejmë në pikat e karburantit, në minimarket, në supermarket, është një spirale e çmendur që ndodh në të gjithë botën. Megjithatë, në diskutimin për buxhetin flitet ende për ta baltuar atë, madje edhe në një vit, kur janë marrë të gjitha masat, që do t'i listoj, të cilat i kanë listuar më parë të gjithë kolegët e maxhorancës, të Partisë Socialiste, për t'ia dalë edhe krizës së tretë, si dy krizave të mëparshme.

Çdo buxhet duhet të ketë një titull, ndaj për vitin 2023 titulli i tij është: mbështetja e familjeve shqiptare për t'ia dalë krizës, duke e mbajtur të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike; duke mbështetur 70 mijë të punësuar me të ardhura të ulëta; duke rritur pragun e patatueshëm nga 40 mijë në 50 mijë; duke e rritur nivelin e pagës minimale, e cila para 3-4 vjetësh ishte 36 000 lekë dhe sot synon të shkojë 40 000 lekë deri në fund të mandatit; duke e ndihmuar skemën me familje, të cilat vijnë me mbështetje nga ndihma ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar.

Mbështetje të veçantë kanë gratë dhe nënat, të cilat kanë një rritje me gati 10% të ndihmës ekonomike, që është rritja e dytë nga fillimi i këtij mandati.

Të rinjtë mbështeten me një garanci sovrane, ku rreth 1000 familje të reja do të mbështeten për blerjen e banesës për herë të parë.

Jo më pak në vëmendje janë pensionistët, të cilët për herë të parë në vitin korrent patën një indeksim me dy herë, me një normë prej 9,5%, i cili nuk do të jetë vetëm për këtë vit, por për çdo vit në vijim; për ta do të jetë edhe bonusi i fundvitit.

Rritja e pagave nuk ka munguar asnjë vit buxhetor, pavarësisht se sa i vështirë ka qenë ai për të përballuar krizën.

Për fermerët, pa dashur të hyj në përsëritje të asaj që tha ministrja, ndihma e IPARD-it është në raport me skemat kombëtare, ashtu edhe me skemat ndërkombëtare, e cila synon të ketë 18 500 përfitues deri në vitin 2025.

Të nderuar kolegë, të menaxhosh financat publike në një periudhë të vështirë, është përgjegjësi shumë e madhe, të cilën qeverisja socialiste e ka treguar më shumë sesa dy herë, por të përballësh me të pavërteta, si me ato që e fillova fjalimin tim, është shumë më e vështirë, sepse është e vështirë të diskutosh me qytetarin për t'ia dalë. Ne ia dolëm në krizën e parë dhe të dytë, sepse ishim të gjithë bashkë, sepse e luftuam të dyja palët pjesën e vështirë të pandemisë, por të thuash të pavërteta, mbi të gjitha, të mohosh përpjekjen e qeverisë për t'ia dalë në situata të vështira, është vetëm një punë, e cila nuk e ndihmon daljen nga kriza, përkundrazi i ndihmon ata që e sollën krizën.

Përse themi që ia kemi dalë dhe pse jemi besimplotë se do t'ia dalim? Të ardhurat në buxhetin e shtetit janë rritur çdo vit. U dëgjua pak më parë që 2,6% është shumë e vogël në rajon, por është pozitive. Produkti i brendshëm bruto me 2,6% ndihmohet kryesisht nga rritja e eksporteve. Do të rriten investimet publike, të cilat janë planifikuar në masën 5,6% të produktit të brendshëm bruto dhe jo më pak e rëndësishme për financat publike është ulja e borxhit, konsolidimi fiskal dhe financiar, i cili shkon në 67,5% nga 68,8%, që parashikohet në vitin 2022.

Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme. Mendoj se për buxhetin e shtetit jo vetëm për vitin që vjen, por edhe për vitet në vijim kemi ende shumë punë për të bërë për të rritur të ardhurat nga ekonomia informale.

Të dëgjosh sot, sidomos në Komisionin e Ekonomisë, se si kolegë të nderuar të opozitës kundërshtojnë pjesë të paketës fiskale, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me dënimin e atyre që e dëmtojnë buxhetin e shtetit, konkretisht me gjoba, është përsëri të pengosh rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Nëse pjesa e informalitetit nuk ka qenë luftuar mjaftueshëm nëpërmjet të gjitha përpjekjeve, të cilat kanë lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm me administratën, por edhe me të gjithë ne, sigurisht buxheti i shtetit nuk synon të arkëtojë nga gjobat, por synon që nëpërmjet gjobave, jo pesëfish apo dhjetëfish, siç jeni mësuar të keqinformoni, por me gjoba proporcionale të dënojnë ata që dëmtojnë ekonominë e këtij vendi prej 30 vjetësh. Edhe kur pimë kafe, shpesh nuk i shikojmë faturat nëse janë të fiskalizuara apo jo, ndaj indirekt jemi duke ndihmuar për mungesën e formalizimit në ekonomi, pasi edhe kjo është një punë e përbashkët. Por të kundërshtosh penaltetet apo dënimet për ata që në mënyrë të vazhdueshme pengojnë sot dhe për 30 vjetët rritjen e pagës reale, e cila do të sjellë më shumë të ardhura në buxhetin familjar, do t'i rritë nesër më shumë pensionet e tyre, atëherë edhe një herë po flasim për një opozitarizëm, i cili shkon larg objektivit për një Shqipëri të qëndrueshme të shëndetshme.

Skema e pensioneve sot në një pjesë të konsiderueshme financohet nga buxheti i shtetit dhe e gjithë përpjekja për t'i rritur të ardhurat shkon për të mbështetur jo vetëm të ardhurat familjare, jo vetëm pensionin, por edhe deficitin e skemës së pensioneve. Ndaj për të gjithë kjo është një betejë, e cila duhet të shkojë drejt synimit të përbashkët të një ekonomie të qëndrueshme, një ekonomie formale dhe një opozitarizmi të saktë dhe jo përbaltje me gënjeshtër e dezinformime.

Faleminderit!